

Aksidentet rrugore për vitin 2012

(Vlerësimi i gjendjes së sigurisë rrugore në vendin tonë)

Siguria rrugore është një shqetësim i madh shoqëror dhe aksidentet rrugore mbeten problem i rëndësishëm shëndetësor dhe ekonomik me të cilin përballet vendi ynë.

Nga analiza vjetore e Policisë së Shtetit rezulton se kemi një rritje të aksidenteve në autostrada, aksidente që kanë rritur shkallën e fatalitetit, si pasojë e përfshirjes në to të më shumë se një mjeti.

“ Gjithashtu, konstatohet se ka rritje të numrit të aksidenteve në autostrada, por nga ana tjetër, kemi ulje numerike të aksidenteve në rrugët urbane kryesore e dytësore, si edhe në rrugët lokale”.

Të dhënat e Policisë Rrugore tregojnë se gjatë vitit 2012 kanë ndodhur 1994 aksidente, 6 më pak se në vitin 2011.

Sërish mbeten shumë problematike akset rrugore Fushë-Krujë-Milot-Lezhë, autostrada Tiranë-Durrës etj. Në aksin e parë, aksidentet kanë ardhur si pasoë e shpejtësisë mbi normat e lejuara dhe parakalimet e gabuara. Në konsideratë janë për t'u marrë edhe kushtet e këqia teknike të rrugës në këtë aks, mospërfundimi i punimeve në disa segmente, mungesa e sinjalistikës, kryqëzimet e rrugëve dytësore me atë kryesore etj.

Vetëm në gjashtëmuajorin e parë, kemi një mijë aksidente në të cilët janë përfshirë 1275 persona, për pasojë janë 187 të vdekur dhe 1088 të plagosur e të lënduar. Vihet re luhajtje e statistikave nga një muaj në tjetrin, ku më të ngarkuarit kanë qenë sërish muajt e verës.

Kështu, nëqoftese në muajin shkurt kemi përkatësisht 129 aksidente me 21 të vdekur, në muajin korrik kjo shifer rritet ndjeshëm; në aksidente humbin jetën 49 persona dhe plagosen 223 të tjerë. (Kjo shifër është më e reduktuar se disa vite më parë; në vitin 2009, gjatë këtij muaji u aksidentuan me pasojë vdekje mbi 70 persona)

Megjithatë, po të vëzhgojmë aksidentet e ndodhura në janar të vitit 2012, në krahasim me ato të një viti më parë, vërehet një rritje e ndjeshme. Kështu, në janar të vitit 2011 kishim 83 aksidente, ndërsa një vit më pas, për të njëjtën kohë, ato arritën në 173 aksidente.

Si numri i aksidenteve ashtu edhe personave të përfshirë në to, me të vrarë e të plagosur rëndë, mbetet në ato parametra. Për pasojë, vërejmë se nga aksidentet automobilistike në të gjithë vendin, gjatë 5 viteve të fundit kanë vdekur 1742 persona dhe 5108 të tjerë janë plagosur rëndë.

Shpejtësia dhe sjellja agresive kanë shkaktuar 29% të vdekjeve dhe 32% të plagosjeve.

Kalimtarët llogariten për 34% të të vrarëve.

Drejtuesit e rinj (18-24 vjeç) janë përgjegjës për 17% të vdekjeve dhe 26% të plagosjeve.

Drejtuesit e rinj pa eksperiencë janë përgjegjës për 38.5% të të gjithë vdekjeve në dy vitet e fundit.

Drejtimi në gjendje të dehur ishte shkak i 6,7% të vdekjeve dhe 5,4% të plagosjeve në 2009.

Mjetet tregtare janë më pak se 11% e inventarit të përgjithshëm, por janë përgjegjës për rreth 18% të vdekjeve dhe 32 % të plagosjeve.

Mospërdorimi rripave të sigurimit, përpara dhe pas, ka sjellë plagosjen deri vdekjen e pasagjerë kur, 40% e këtyre pasojave mund të ishin eliminuar duke mbajtur rripin e sigurimit.

Për Tiranën kemi këto të dhëna për qarkullimin rrugor, aksidentet e shkaqet e tyre.

Këto të dhëna janë marrë nga monitorimet e dhjetë muajve të parë të vitit 2012.

Gjatë këtij dhjetëmujori, në trafikun e Tiranës kanë ndodhur gjithsej 283 aksidente automobilistike me 17 persona të vdekur, 27 të plagosur rëndë dhe 281 persona të plagosur lehtë.

Po të krahasohen me të njëjtën periudhë të vitit 2011, evidentohen 5 persona me pasojë vdekjen më pak , 7 të plagosur rëndë dhe 30 persona të plagosur lehtë më pak.

Gjatë këtij dhjetëmujori, aksidentet janë reduktuar me 39 aksidente ose 12.1 %, në krahasim me dhjetëmujorin e vitit të kaluar.

Rreth 60 % e aksidenteve kanë ndodhur në rrugët e brendshme të qytetit, ndërsa 32% kanë ndodhur në rrugët interurbane.

Po rendisim disa të dhëna:

-Kemi 158 ose 55.8 % të aksidenteve që kanë ndodhur në rrugët urbane kryesore.

- 53 aksidente ose 18.7 % që kanë ndodhur ditën e martë,

-Po kështu,64 aksidente ose 22.6 % që kanë ndodhur në orën 19 oo – 24oo.

Nga treguesit e mësipërm, për faj të drejtuesve të mjeteve kanë ndodhur 208 aksidente ose 73.4 % dhe, 75 aksidente ose 26.5 % kanë ndodhur për faj të këmbësorëve, 67 ose 23.6 % e aksidenteve janë shkaktuar nga drejtues të moshës 25-35 vjeç, ndërsa 83 ose 29.3 % nga drejtues mjeteve me eksperience 3-6 vjeçare.

Janë ndaluar administrativisht (bllokuar) gjithsej 8 417 mjete, si dhe janë tërhequr nga

efektivi 1 048 leje drejtimi.

Gjatë vitit 2012 janë vendosur 106 668 gjoba dhe janë arkëtuar 123 465 gjoba ose 115.4%, ndërsa në vlerë janë vendosur 113 717 091 lekë dhe arkëtuar 154 570 002 lekë, e shprehur në përqindje janë arkëtuar 115 % në numër dhe 135 .9 % në vlerë.

Nga të cilët: 31 868 gjoba të vendosura për mospërdorimin e rripit të sigurimit, 4 326 gjoba për qarkullim me të meta teknike, 7 341 gjoba për mosrespektim të normave të shpejtësisë dhe 14 215 gjoba për mosrespektim të sinjalistikës rrugore.

Aksidentet rrugore pësojnë një rritje gjatë sezonit turistik, kjo për shkak të rritjes së fluksit të lëvizjes dhe shtimit të numrit të mjeteve që vijnë nga jashtë kufijve.

Zona më problematike për sigurinë rrugore mbetet ende rruga e Durrësit, ku koncentrimi më i lartë është në segmentin Laprakë, tek rrethrotullimi i Doganës.

Duhet vërejtur se shoqëria humbet miliona euro çdo vit nëpërmjet dëmeve të pronës, shpenzimeve mjekësore dhe produktivitetit të papërfutur.

Fatkeqësisht, shumë nga viktimat e aksidenteve rrugore janë të moshës 16 – 44 vjeç dhe janë pjesa më produktive e popullatës sonë. Nqs nuk do të ketë ndërhyrje, këto humbje të tmerrshme njerëzore dhe ekonomike do të vazhdojnë të rriten në vitet e ardhshme.

Shpenzimet në lidhje me sigurinë rrugore duhet të shihen si një përparësi e lartë dhe si një investim, por jo një kosto. Kështu që, ne të gjithë duhet të punojnë së bashku për të zgjidhur këtë çështje urgjente.

Vërejmë se:

Shqipëria përballlet me një sfidë të madhe përse i përket garantimit të sigurisë më të lartë të rrugëve në rajon. Kjo sfidë është veçanërisht e vështirë në një mjedis me zhvillim të shpejtë ekonomik, i cili do të çojë në rritjen e transportit rrugor.

Siguria rrugore është një përparësi në Shëndetin Publik dhe zhvillimin në vëndet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, prandaj dhe humbjet e papranueshme të shëndetit janë të lidhura me ndikimet negative ekonomike dhe sociale të ndodhura në rrjetet rrugore të tyre.

Siguria rrugore është përgjegjësi e çdo personi prandaj, të gjithë duhet të shohim se çfarë mund të bëjmë për të ndikuar në familjet tona, shokët dhe bashkëpunëtorët, për të adoptuar mënyra të sigurta të sjelljeve për sigurinë rrugore.

Në mënyrë që shtimi i udhëtimeve të mos çojë në rritjen e numrit të aksidenteve, duhen marrë masa efektive në lidhje me një sërë aspektesh të sigurisë rrugore siç janë: përgatitja dhe testimi i drejtuesve të mjeteve, kontrolli i mjeteve për drejtim të sigurt, sjellja e përdoruesve të rrugës dhe siguria e infrastrukturës rrugore.

Juridiksione të ndryshme nëpër botë kanë treguar se vdekjet nga aksidentet rrugore mund të ulen në 30 – 50 % me anë të zbatimit të planeve të veprimit të sigurisë rrugore me bashkërendim shumësektorial brenda një strategjie të përgjithshme me shumë ambicie, por njëkohësisht me objektiva të arritshëm.

Disa nga drejtimit dhe ndërhyrjet e zbatuara për parandalimin e aksidenteve.

Analizat e situatës së aksidenteve në Shqipëri, me një numër kaq të lartë të tyre dhe me rritje të papranushme krahasuar me ato të vëndeve të tjera të Evropës, tregojnë se ka një nevojë urgjente për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë problem.

Ka nevojë për të ndryshuar sjelljet jo të përshtatshme të drejtuesve dhe për të përmirësuar edukimin e të gjithë njerëzve të cilët do të marrin pjesë në trafik.

Fokusi është edukimi në shkolla me rregullat e qarkullimit rrugor.

Synimi është jo vetëm sigurimi i jetës së fëmijëve nga rreziqet e mundshme gjatë kohës që ata lëvizin në rrugë, por edhe formimi i sjelljeve të përshtatshme, që ata të reflektojnë nesër si përdorues të rrugës e mjeteve motorike.

Në objektivat për dekadën e sigurisë rrugore 2011-2020, për sjelljen e përdoruesve të rrugës, do të synohet hartimi i programeve gjithëpërfshirëse, për të përmirësuar edukimin rrugor me të gjithë grupmoshat.

Këtu, një vend me peshë të veçantë ka edukimi i fëmijëve për sigurinë në rrugë.

Ndër më kryesorët është ai në fushën e parandalimit të aksidenteve, puna për ndryshimin e sjelljes së përdoruesve të rrugës, si dhe edukimi në shkolla të cikleve të ndryshme.

Qëllimi:

Të parandalojmë aksidentet rrugore (dhe jo vetëm këto trauma) nëpërmjet edukimit të fëmijëve dhe të rinjve, përfshirjes së komunitetit, ngritjes së kapaciteve njerëzore për të edukuar dhe dhënë ndihmën e shpejtë në kohë.

Siguria Rrugore është një problem kompleks e shumësektorial dhe, askush i vetëm nuk do të mund të arrijë zgjidhjen e problemeve të sigurisë, me të cilat do të përballet vendi në vitet në vazhdim.

Për zbatimin e një plan-veprimi gjithëpërfshirës dhe shumësektorial, nevojitet një bashkëpunim efektiv ndërmjet agjensive dhe palëve të interesuara, jo vetëm agjensive të rëndësishme qeveritare por edhe sektorit privat dhe OJF-ve.

Duke konstatuar dhe pranuar problemin në rritje dhe sfidat për të ardhmen, Qeveria Shqiptare ka inicuar dhe hartuar tashme Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Rrugore dhe zhvillimin e një Plan-Veprimi shumësektorial, për zbatimin e kësaj Strategjie.

Zhvillimi i kësaj Strategjie ka mbledhur një ekip specialistësh, të cilët kanë analizuar problemin dhe kanë vlerësuar nivelet ekzistuese të sigurisë rrugore për të gjithë sektorët dhe agjensitë kyçe në Shqipëri, ku një vend të rëndësishëm ka edhe Sektori i Shëndetësisë me të gjithë komponentët e saj.

Ky dokument ka për qëllim zgjidhjen e rrethanave, problemeve dhe nevojave specifike të vendit, duke i kthyer kështu rrugët e Shqipërisë në rrugët me të sigurta në rajon.

Realizimi i detyrave për rritjen e parametrave të Sigurisë Rrugore, sigurimin e një trafiku normal për përdoruesit e rrugës, parandalimin e aksidenteve automobilistike, rritjen e edukatës rrugore dhe besimit në komunitet, ka qenë dhe do të vazhdojë të mbetet një ndër përparësitë e Shërbimeve të Policisë Rrugore.

Përgatiti. Boris Miska specialist në Departamentin e Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit

Tiranë shkurt 2013..

Shënim;

Të dhënat e mësipërme janë publikuar nga Policisa Rrugore Tiranë, në analizën vjetore të Policisë së Shtetit (pjesa e sigurisë rrugore), monitorimi i medias së shkruar dhe elektronike, diskutimi dhe promovimi i Dekadës së parandalimit të aksidenteve 2010-2020 etj.